**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME**
**ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/561

## Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Carralevë

E martë, më 13 qershor 2023
Kohëzgjatja e takimit: 19:20 –21:00
Vendi i takimit: SHMFU ''Abdullah Shabani''

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

**1.Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026**

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, z. Adnan Ademi, i cili ka përshëndetur të pranishmit dhe i ka falënderuar që kanë gjetur kohë që të jenë prezent. Ai më tutje vazhdoi dhe tregoi rëndësinë që ka ky takim për banorët dhe vetë fshatin Carralevë. Z. Ademi foli rreth investimeve dhe kërkoi nga banorët që nevojat e tyre t'i paraqesin sot dhe më pas në bazë të këyre kërkesave të bëhet një plan për buxhetin e vitit 2024, ku gjërat më primare që i ngritën banorët të jenë pjesë e investimeve. Pas përfundimit të fjalimit të tij, z. Adnan Ademi i dha fjalën Drejtorit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Grejtalb Emini.

Drejtoi Emini në pika më të gjera shpjegoi investimet të cilat do të bëhen në këtë fshat, duke kërkuar nga banorët që të bashkëpunojnë dhe kërkesat të cilat ata i kanë t'i adresojnë sot tek ne.

Kërkesat e banorëve të fshatit Carralevë:

- **Ismet Fazlija:** Të rregullohet kanalizimi në të gjithë fshatin
- **Tahir Qerkini:** Të rregullohet kanalizimi dhe ujësjellësi, të mirëmbahen trotuaret, rregullimi i rrugës Carralevë-Zborc, rregullimi i rrugës te varrezat si dhe të vendosen patrolla të policisë
- **Besnik Beha:** Në lagjen e "Behovitëve", të vendosen trotuare dhe ndriqim
- **Lulzim Balaj:** Në lagjen "Balaj", të rregullohet kanalizimi, si dhe te bëhet rivitalizimi i rrugës
- **Festim Hasani:** Të rregullohet ndriqimi tek lagjja "Hasani"
- **Arben Fazliu:** Në rrugën "Rrahman Tafa", të rregullohet kanalizimi
- **Safet Hajrizi:** Të lëshohet shkolla e re si dhe të ketë ndonjë park apo teren sporti

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Vendi: Carralevë

Date: 13.06.2023

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|---|---|---|
| 1 | ISMET FAZLIJA | |
| 2 | ARBEN FAZLIJA | |
| 3 | BASRI HYSENI | |
| 4 | TAHIR QERKINI | |
| 5 | AGIM QERKINI | |
| 6 | Sofet Hojrani | |
| 7 | Argim Abdulla | |
| 8 | Arsim Balaj | |
| 9 | Besnik Beha | |
| 10 | LULZIM BALAJ | |
| 11 | BEKIM BETOMAN | |
| 12 | Osman Fetullohi | |
| 13 | FESTIM HASANI | |
| 14 | FRESKIM AGRIFI | |
| 15 | Kadri [illegible] | |
| 16 | Argent Fazliu | |
| 17 | Edon Hasani | |
| 18 | BESJAN MURTEZI | |
| 19 | GRBLIM QERKINI | |